



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

**1. Përmbledhja ekzekutive** (*pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë*)

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) ka miratuar 3 akte që plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e procesit të konsultimit publik për vitin 2022:

1. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024 (PKIE 2022-2024) i përgatitur nga grupet ndërinstitucionale të punës për secilin kapitull të *acquis* si dhe ministritë përgjegjëse për secilin kapitull të negociatave të pranimit në BE.
2. Projektligj “Për shfuqizimin e ligjit nr.115/2017, “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar”;
3. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar”.

Për konsultimin publik të PKIE 2022-2024 u përdorën metodat si më poshtë:

- Konsultimi publik nëpërmjet Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP);
- Konsultim në kuadër të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”;
- Takim publik konsultues me aktorë jo shtetëror.

Konsultimi publik i projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024” ka patur një kohëzgjatje 20 ditë pune nga momenti i shpalljes në RENJKP. Projektakti u shpall në regjistrin elektronik për konsultim në datën 7.1.2022 dhe afati i fundit ishte data 3.2.2022. Konsultimi publik për PKIE 2022-2024 në regjistrin elektronik të konsultimit publik të projektakteve ishte një konsultim i hapur për çdo individ apo organizatë e interesuar për procesin e integritimit evropian për të dhënë mendim apo sugjerime mbi projektaktin.

Në kuadër të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.8.2019, MEPJ me shkresën nr.17513, datë 6.12.2021 solli në vëmendje të ministrive dhe institucioneve lider të grupeve ndërinstitucionale të punës, konsultimin publik për projektvendimin “Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024 (PKIE 2022-2024)”, sipas kapitujve përkatës, në tryezat e partneritetit të ngritura dhe konstituara.

Nga ministritë dhe institucionet lider të grupeve ndërinstitucionale të punës, procesi i konsultimit të PKIE 2022-2024, u zhvillua për 15 tryezat e diskutimit dhe këshillimit të ngritura pranë grupeve ndërinstitucionale të punës për kapitujt e *acquis*. Vlen të përmendet se procesi i konsultimit të PKIE nëpërmjet mekanizmave të Platformës së Partneritetit Publik ndodh për herë të parë dhe, ka vlerë të

posaçme jo vetëm për institucionalizimin e këtij procesi në vijimësi, por edhe për krijimin e besimit dhe urave të bashkëpunimit mes strukturës negociuese dhe grupeve të interesit.

Më 3.2.2022 pranë hotel Rogner u zhvillua takimi konsultues në kuadër të rishikimit të PKIE 2022-2024). Për arsye të masave shtrënguese në kuadër të situatës së pandemisë, të shkaktuar nga COVID19, takimi u organizua në format hibrid me prezencë fizike të limituar dhe *online* nëpërmjet platformës ZOOM. Drejtorja e Bashkimit Evropian në MEPJ, për organizimin e këtij takimi pati dhe mbështetjen e asistencës teknike SEI, e cila dha kontributin e saj për pjesën logjistike të organizimit të takimit. Në takim morën pjesë 27 pjesëmarrës të cilët përfaqësonin grupe të ndryshme interesi, shoqëri civile dhe grupe të tjera interesi, 13 me prezencë fizike dhe 14 të tjerë nëpërmjet platformës ZOOM.

Procesi i konsultimit publik është kryer edhe për dy projektaktet e mëposhtme, të janë miratuar në vitin 2022:

1. Projektligj “Për shfuqizimin e ligjit nr.115/2017, “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar”;
2. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar”.

Për konsultimin publik të tyre u përdor metoda:

- Konsultimi publik nëpërmjet RENJKP;
- Konsultim në kuadër të urdhrit të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr.194, datë 3.6.2022, për ngritjen e Grupit Ndërmintor të Punës, për hartimin e projektligjeve.

Konsultimi publik i projektligjeve ka patur një kohëzgjatje 20 ditë pune nga momenti i shpalljes në RENJKP. Projektaktet janë shpallur në regjistër për konsultim në datën 22.6.2022 dhe afati i fundit ishte data 19.7.2022. Konsultimi publik ishte i hapur për çdo individ apo organizatë të interesuar për të dhënë mendim apo sugjerime mbi projektligjet.

Nuk ka patur komente për konsultimin e këtyre projektakteve.

Ndërkohë janë zhvilluar disa takime konsultuese me anëtarët e Grupit Ndërmintor të Punës të ngritur për hartimin e këtij projektligji me urdhër të ministrit. Takimet në strukturat e brendshme janë mbajtur që me miratimin e VKM nr.81, datë 9.2.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore për MEPJ”, që kaloi çështjet e diasporës në përgjegjësinë e MEPJ.

Nga miratimi i urdhrit nr.194, datë 3.6.2022, janë mbajtur dy takime në datat 6 dhe 9 qershor 2022. Korrespondencë shkresore ndërinstucionale për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar”, nr. 10738, datë 27.7.2022. Korrespondencë shkresore ndërinstucionale për projektligjin “Për shfuqizimin e ligjit nr.115/2017, “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar”, nr.10458, datë 25.7.2022.

Korrespondencë elektronike nëpërmjet sistemeve e-akteve në qershor, tetor dhe nëntor 2022.

Projektligjet janë konsultuar paraprakisht edhe me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentin e Administratës Publike.

## **2.Analiza e konsultimeve të kryera**

### ***2.1.Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

*2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?*

MEPJ ka miratuar gjithsej 40 akte në Këshill të Ministrave për vitin 2022, 8 prej të cilave si institucion bashkë-propozues.

*2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*

Janë konsultuar 3 akte, që plotësonin kriteret për t'iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, në përputhje me ligjin nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik":

*2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

2 projektligjet janë konsultuar me raporte VNR-je. Për PKIE 2022-2024 nuk aplikohet kriteret e zbatimit të VNR.

*2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Kriteret e përjashtimit janë përdorur për 9 akte të planifikuara në PPAP , në përputhje me nenin 4(b) të ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare dy dhe shumëpalëshe.

Lidhur me PKIE dhe dokumentat strategjik, nuk përbën përjashtim pasi është vet PKIE.

*2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian u propozua projektvendim dhe u miratua me VKM nr.91, datë 9.2.2022 "Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2022–2024".

2 projektaktet e tjera janë propozuar projektligje.

*2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Në krahasim me vitin e kaluar, situata e konsultimit publik, ka patur një përmirësim në metodat e konsultimit që ka sjellë një pjesëmarrje më të gjerë dhe një numër të konsiderueshëm komentesh mbi projektaktin.

## **2.2. Metodat e konsultimit**

*2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat më të përdorura janë konsultimi nëpërmjet RENJKP dhe konsultimi në kuadër të Urdhrave për ngritjen e GNP.

Për PKIE 2022-2024 është përdorur edhe metoda e takimit publik konsultues me aktorë joshtetëror.

*2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda e konsultimit nëpërmjet takimit publik konsultues ishte metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve. Gjatë periudhës së konsultimit nëpërmjet RENJKP u gjenerua vetëm një koment.

*2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Nuk janë organizuar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit për PKIE. Ndërkohë janë organizuar konsultime paraprake brenda institucionit dhe ndër-institucionale për projektligjin "Për shfuqizimin e ligjit nr.115/2017, "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", i ndryshuar" dhe projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 "Për diasporën", i ndryshuar".

### **2.3.Kohëzgjatja e konsultimeve**

*2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

4 proceset e konsultimit, për të tre projektaktet kanë qenë të hapura për 20 ditë pune.

*2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ishte 20 ditë pune.

*2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Edhe në vitin e kaluar kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë 20 ditë pune.

### **2.4.Palët e interesuara të përfshira**

*2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

Nuk ka patur palë interesi të jashtme në grupet e punës brenda MEPJ-së për hartimin e projektligjeve dhe për PKIE 2022-2024.

PKIE është e ndarë në kapitullin "Kriteri Politik" dhe "Kriteri ekonomik" si dhe pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve negociues. Procesi i planifikimit të PKIE-së kryhet nga institucionet përgjegjëse/lider të kapitujve. Gjatë gjithë procesit të planifikimit MEPJ koordinon punën me GNPIE-të e të 33 kapitujve për hartimin e PKIE-së. Vlen të përmendet kontributi i asistencës teknike SEI për hartimin e udhëzuesit "Për

hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian” që shërbeu si metodologji për te gjithë grupet ndërinstitucionale të punës për hartimin e PKIE 2022-2024.

**2.4.2** *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Referojuni pikës 2.4.1.

**2.4.3** *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Numri i palëve të interesuara që morën pjesë në të gjithë fazat e konsultimit publik ishte 42 pjesëmarrës të cilët përfaqësonin grupe të ndryshme interesi, shoqëri civile dhe aktorë të tjerë jostetëror. Nga 42 pjesëmarrës pati 13 komente nga të cilat u pranuan vetëm 5 komente.

**2.4.4** *Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Të 42 pjesëmarrësit në proceset e konsultimit publik të PKIE 2022-2024 kanë qenë përfaqësues të personave juridike si shoqata biznesi, shoqëri civile.

**2.4.5** *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Në krahasim me vitin e kaluar ku nuk ka patur asnjë pjesëmarrës në konsultim, këtë vit kemi një përmirësim të dukshëm të situatës mbi numrin e pjesëmarrësve në procesin e konsultimit publik të PKIE 2022-2024.

## **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

**2.5.1.** *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Gjatë procesit të konsultimit publik të PKIE 2022-2024 ka patur gjithsej 13 komente. Për projektligjet ka patur 7 komente nga institucionet qeveritare.

**2.5.2.** *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Nga 13 komente të gjeneruara 6 prej tyre u refuzuan dhe 2 komente u pranuan pjesërisht, dhe 5 u pranuan plotësisht.  
7 komentet për projektligjet janë pranuar.

**2.5.3.** *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Tendenca në dhënien e mendimeve krahasuar me vitin e kaluar është në ngritje. Në krahasim me vitin e kaluar ku nuk ka patur asnjë koment, këtë vit kemi një përmirësim në RENJKP me 5 komente.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Janë përditësuar dy VNR për dy projektligjet.

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

3 raporte individuale për projekt-aktet.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Nuk ka patur raporte të pa publikuara.

## **2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)**

MEPJ për vitin 2022 ka konsultuar gjithsej 3 projektakte. Nisur nga kërkesat e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” sugjerojmë vlerësimin maksimal 8 për procesin e kryer të konsultimit publik për to.

## **3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)**

Për të rritur cilësinë dhe transparencën në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore, është e nevojshme të ngrihen kapacitetet e ministrisë për administrimin e konsultimeve publike. Gjithashtu duhet të konsiderohet dhe ristrukturimi organizativ për një shpërndarje më të mirë të personelit dhe përkrahjeje pune të qartë.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është një dokument i rëndësishëm strategjik dhe trajton një informacion të gjerë dhe voluminoz. Vlen të përmendet se kontributi mbi përditësimin e PKIE përcillet nga grupet ndërinstitucionale të punës dhe institucionet lider të kapitujve. Për këtë arsye do ishte në favor të procesit që konsultimi publik i aktit të kryhej për secilën fushë që prek dokumenti strategjik nga vetë institucionet lider të kapitujve që propozojnë ndryshimet në akt dhe për këtë qëllim mund të shërbejë edhe Platforma e Partneritetit Publik e ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr.113, datë 30.8.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”.